



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2022:260504  
Datë: 25.09.2024  
Numri i dokumentit: 06206722

**C-IV-13-1339**

*Ankuesi*

**R D, B e P, Istog**  
*Përfaqësuar nga Av: B I, Prishtinë*

**Kundër**

*E paditura*

**Agjencia Kosovare e Privatizimit**, Rruga “Dritan Hoxha”, Nr. 55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Diellza Hoxha, me 24 shtator 2024 lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. REFUZOHET ankesa si e pabazuar**
- II. VËRTETOHET vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRN105-0160, i datës 10 qershor 2013, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.**
- III. Nuk caktohen taksa gjyqësore për ankuesin.**

**Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me 04 korrik 2013, ankuesi dorëzoi në Dhomën e Posaçme, ankesë kundër Vendimit nr. PRN105-0160, të datës 10 qershor 2013, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), me të cilin ka kërkuar kompensimin për paga të pa paguara, në shumë prej 540.00 Euro, nga NSH “Dardania” (në likuidim).

Ankuesi pohoi se konkludimi i AL-së është plotësisht i pa bazë dhe nuk përkon me realitetin, është kontradiktor me njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, për arsye se AKM-ja me 17 nëntor 2006 i ka ndërprerë marrëdhënien e punës më një shkresë apo njoftim. Po ashtu,

ankuesi pohoi se ndihet i mashtruar nga letra e njoftimi i AKM-së, pasi që është udhëzuar në mënyrë të gabueshme, sepse ka pritur më tepër se tri vite që të paraqes kërkesë para AL-së për pagat të cilat i ka mbetur borxh NSH-ja dhe duke ju përmbajtur këtij njoftimi zyrtar nuk ju ka drejtuar gjykatës për realizimin e kërkesës së tij. Ankuesi nuk i ka bashkangjitur ndonjë provë ankesës së dorëzuar në gjykatë.

Me 06 janar 2014, gjykata lëshoi urdhër për ankuesin, duke kërkuar nga ai që të dorëzojë vendimin e AL-së si dhe prova tjera në mbështetje të ankesës. Me 22 janar 2014, ankuesi është përgjigjur në urdhër, duke dorëzuar si provë vendimin e AL-së.

Me 28 prill 2014, e paditura në mbrojtjen e saj të parashtruar kundër ankesës, pohoi se ankesa është e pabazuar, kërkoi që vendimi i atakuar i AL-së, të vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj dhe se AL-ja ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike si dhe dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. AKP-ja pohoi se ankuesi nuk është mashtruar nga korrespondenca me AKP. Më tej, e paditura pohoi se kërkesa e ankuesit është e parashkruar, pasi ai ka dështuar të dorëzojë kërkesën e tij pranë gjykatës brenda tre vjetësh prandaj nuk ka bazë ligjore për të zhvleftësuar vendimin e AL.

Me 27 maj 2014, mbrojtja e AKP është dorëzuar të autorizuarit të ankuesit. Me 16 qershor 2014, i autorizuari i ankuesit është përgjigjur në mbrojtjen e AKP-së, duke mbetur në atë që është thënë në ankesën e dorëzuar në gjykatë.

Me 08 korrik 2014, gjykata përmes urdhrit ia dërgon përgjigjen në mbrojtje të ankuesit AKP-së, Me 15 gusht 2014, AKP-ja me kundërpërgjigje është përgjigjur në urdhrin e gjykatës.

### **Arsyvetimi ligjor:**

Ankesa refuzohet si e pabazuar.

Ne bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet relevante të lëndës janë të pakontestueshme dhe lëshon këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe konstaton se njëra ndër çështjet thelbësore kontestuese, ndërmjet palëve është çështja e parashkrimit, që si e tillë është çështje e rregulluar me dispozita ligjore dhe meqenëse gjykata konstaton se është parashkruar e drejta për të kërkuar në rrugë gjyqësore përmbushjen e detyrimit, pretendimet e tjera të palëve nuk do të shqyrtohen.

Neni 37.4.4.1 i Shtojcës së Ligjit për AKP-në, parasheh:

*kërkesat që konsiderohen të jenë të pasafatshme sipas afatit të kufizuar të përcaktuar me ligje të aplikueshme, si dhe kërkesat që nuk janë parashtruar në mënyrë të rregullt apo në kohë para gjykatës kompetente, refuzohen dhe nuk gëzojnë të drejtë për të marrë pjesë në disbursimet nga likuidimi;*

Gjykata gjen se neni 608 i ligjit për Punën e Bashkuar (Gazeta Zyrtare nr. 53/76) në të cilin ishte mbështetur vendimi refuzues i AKP-së ishte shfuqizuar me Ligjin mbi Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit mbi Ndërmarrjet (GZ 40/89) i cili ligj kishte hyrë në fuqi me 15 korrik 1989, konkretisht me nenin 74, i cili nen e plotëson Ligjin mbi Ndërmarrjet (GZ 77/88, (i cili kishte hyrë në fuqi me 01 janar 1989), konkretisht nenin 196 i cili qartësisht normon shfuqizimin e të gjitha dispozitave të Ligjit mbi Punën e Bashkuar, përveç dispozitave nga Kreu IV dhe Kreu i VI kaptina 2, dispozita e nenit 608 është e vendosur në Kreun e VI në kaptinën e 3, që do të thotë se është shfuqizuar me këtë ndryshim plotësim të ligjit. Ligji mbi Marrëdhënien e Punës i datës 14 prill 1989 dhe Ligji për të drejtat themelore nga marrëdhënia e punës i datës 28 shtator 1989, nuk kanë paraparë dispozita të veçanta lidhur me parashkrimin e kërkesave monetare që lindin nga marrëdhënia e punës, megjithatë kjo nuk do të thotë se instituti i parashkrimit për kërkesat monetare ka mbetur i pa mbuluar me dispozita të tjera ligjore.

Gjykata vlerëson se, për kohen kur pretendohet se është krijuar detyrimi, duhet të aplikohet parashkrimi i përgjithshëm për detyrimet civile. Këto rregulla gjinden në Ligjin mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) nr. 690 të datës 30 mars 1978, të njëjtat rregulla gjinden edhe në Ligjin nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) i cili ka hyrë në fuqi më 19 dhjetor 2012. Në pajtim me nenin 372, paragrafi 1 i LMD-së, parashkrimi i kërkesave periodike siç është paga, është tri (3) vjet; Ligji i ri ka mbajtur të njëjtin afat parashkrimi prej 3 vitesh (neni 353, paragrafi 1, i LMD-së). Po ashtu, Ligji i Punës nr. 03/L-212 i cili është në fuqi, nuk parasheh dispozitë të veçantë për parashkrimin në lidhje me pagesat e të ardhurave, por parasheh një afat të përgjithshëm prej 3 viteve të parashkrimit, në lidhje me kërkesat që lindin nga marrëdhënia e punës. Nga dispozitat e lartcekura, gjykata vlerëson se parashkrimi si institut i së drejtës civile në përgjithësi dhe në veçanti afati 3 vjeçar i parashkrimit për kërkesat monetare, është ruajtur në të gjitha ligjet që kanë qenë të aplikuara në atë kohë, por edhe në ligjet që tani janë në fuqi.

Prandaj, shihet se parashkrimi për kompensim për paga të pa paguara në shumë prej 540.00 Euro, të kërkuar në këtë lëndë (sipas vet pohimit të ankuesit, kërkesa ka të bëjë me pagat e pa paguara për periudhën mars – nëntor 2006) ishte i rregulluar me LMD-në (1978), i cili ishte ligj ende në fuqi në atë kohë. Vetëm në dhjetor 2012 ligji i aplikueshëm ndryshoi, por edhe LMD tani në fuqi ka mbajtur të njëjtin afat parashkrimi prej 3 vjetësh.

Me vjetërsim/parashkrim, ligjërisht shuhet e drejta e kërimit të përmbushjes së detyrimit, parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër. Në rastin konkret, e drejta për të kërkuar kompensimin e pretenduar për paga të pa paguara, është ligjërisht e vjetërsuar pas 3 viteve, pasi që NSH-ja nuk ka përmbushur detyrimin e saj ndaj

parashtruesit së kërkesës brenda këtij afati dhe pasi që ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi se ka paraqitur kërkesë në ndonjë procedurë gjyqësore, apo para ndonjë autoriteti kompetent brenda afatit 3 vjeçar, për të kërkuar borxhin e pretenduar në lidhje me pagat e pa paguara dhe kështu për ta ndaluar rrjedhjen e afatit të parashkrimit. Sipas shkresave të lëndës, ankuesi kërkesën e ka parashtruar lidhur me pagat e pa paguara për periudhën mars – nëntor 2006, në shumë prej 540.00 Euro, për kohën kur ka ofruar shërbime për NSH-në. Nga shkresat e lëndës rrjedh se ankuesi kërkesën e ka parashtruar pranë Autoritetit të Likuidimit më 21 dhjetor 2010, brenda afatit për parashtrimin e kërkesave pranë AL-së, por që në bazë të dispozitave ligjore të lartcekura, një kërkesë e tillë në atë kohë vetëm se ishte parashkruar.

Ankuesi ka pasur të drejtë të kërkoj përmbushjen e detyrimit të pretenduar në kohën kur nuk i janë paguar pagat, përkatësisht në kohën kur ka ofruar shërbime për NSH-në, kështu që afati i parashkrimit ka filluar të rrjedh menjëherë pasi ka lindur e drejta e kërkesës, përkatësisht nga muaji nëntor 2006. Kërkesa e ankuesit për kompensim për paga të pa paguara, është parashkruar brenda afatit 3 vjeçar, që i bie se afati i parashkrimit ka arritur në muajin dhjetor të vitit 2009, ankuesi kërkesën e ka parashtruar në muajin dhjetor të vitit 2010, që do të thotë jashtë çdo afati të paraparë ligjor. Ankuesi, me parashtrimin e ankesës kundër vendimit të AL-së, nuk ka pohuar ndonjë fakt apo argument ligjor që do të bënin ndryshimin e rrethanave faktike, sa i përket parashkrimit të së drejtës për të kërkuar në rrugë gjyqësore pagat e pa paguara dhe kështu për të ndikuar në ndryshimin e vendimit të ankimuar.

Pretendimi i ankuesit se borxhi është pohuar nga e paditura dhe afati i parashkrimit është ndërprerë me letër pezullimin e lëshuar nga AKM, me 17 nëntor 2006, është i pabazuar pasi gjykata konsideron se një pretendim i tillë nuk është i mbështetur në prova. Ankuesi një provë të tillë nuk e ka dorëzuar si provë kur është parashtruar ankesa, Prandaj, gjykata vlerëson se edhe nëse letër pezullimi konsiderohet si veprim me të cilin është ndërprerë parashkrimi, në kuptim të nenit 392 të LMD-së, përsëri ka filluar të rrjedh afati i ri i parashkrimit, e që në këtë rast do të thotë se edhe sikur kërkesa e ankuesit të merret plotësisht e mirëqenë përsëri rezultati është i njëjtë, kërkesa për paga të papaguara është parashkruar respektivisht me 17 dhjetor 2009, pra para parashtrimin të kërkesës kreditore pranë AL.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

### **Taksat gjyqësore**

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta. Në pajtim me nenin 13.3 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr. 01/2017, të datës 22 mars 2017, nuk caktohen taksa gjyqësore, në këtë procedurë ankimore, pasi që vlera e objektit të kontestit është nën 1,000.00 Euro.

### **Këshilla juridike**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

---

Diellza Hoxha  
Gjyqtare